

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Padrejtësia më e madhe e shekullit"/ Reagimet e familjarëve të ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://www.cna.al/kosova-bota/padreja-tesia-me-e-madhe-e-shekullit-reagimet-e-familjareve-te-ish-kre-i474316
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:26:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:11:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	83b44017b17cecad2502f2d3e061b0e699b035110a074b36a13e9336747618f0
TEKSTI	883cb0b5e48e0c1a4887a288864e3c2a27b560e5373e29e05f157af472758b33
PAMJA	316266610c800112e4f8fb5ad1449bf9581c0d4dab95014038d3f0f94ed4ae2d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f6efe2d30e88156daa26501962eac4f6a6238948fedc38d399adcd31221db52e
E MËPARSHMJA	8e4e30b1157cafa13ec3b6e80cb462e14149d9a7d05de3c45f99f3880d7ed7d0
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f6efe2d30e88156daa26501962eac4f6a6238948fedc38d399adcd31221db52e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

12:46 Politikë

Politika në Shqipëri ka dënuar vendimin e Gjykatës Special...

“Padrejtësia më e madhe e shekullit”/ Reagimet e familjarëve të ish-krerëve të UÇK-së



16 Shtator 2026, 12:11, Kosova & Bota CNA



Kanë ardhur reagimet e para nga familjarët e ish-krerëve të UÇK-së pas dënimit të tyre me 81 vjet burg nga Gjykata Speciale në Hagë.

Vëllai i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Gani Thaçi, është shprehur se familja pret që Apeli ta përmbyjë vendimin e Gjykatës Speciale me 25 vjet burgim për krime lufte.

“E presim Apelin. Jemi të bindur në pafajësi”, është shprehur shkurtimisht për mediat.

Ndërkohë vajza e Jakup Krasniqit, Gresë Krasniqi, përmes një postimi në “Facebook”, e ka cilësuar vendimin si padrejtësia më e madhe e këtij shekulli. Ajo shkruan se ky vendim ndryshon historinë e Republikës së Kosovës dhe i vendos një njollë të zezë UÇK-së duke barazuar viktimën me agresorin.

“Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, Sot, në qytetin e drejtësisë, ndodhi padrejtësia më e madhe e këtij shekulli. Në një gjykatë që ne e konsiderojmë të padrejtë, politike, raciste dhe kriminale, u dha një vendim po aq i padrejtë, politik, racist dhe kriminal. Ky vendim, përfundimisht, ndryshon historinë e Republikës së Kosovës, i vendos një njollë të zezë UÇK-së dhe barazon viktimën me agresorin. Katër burra që i kthyen armët kundër armikut, jo për të pushtuar e as për pushtet, por për të mbrojtur pragun e shtëpisë që digjej e shkatërrohej; për të mbrojtur familjarët që dhunoheshin, përdhunoheshin, torturoheshin e vriteshin; që zhdukeshin e dëboheshin nga trojet e tyre.


UÇK-ja luftoi kundër kasapit të Ballkanit, kundër një prej ushtrive më të përgjakshme të rajonit, kundër një makinerie ushtarake që kreu gjenocid në Kosovë. E megjithatë, sot u dënuan çlirimtarët. Në këtë gjykatë të padrejtë, sot u dënua zëdhënësi i UÇK-së, ndërsa homologu i tij i atëhershëm, Ivica Daçiç, vazhdon të jetë i lirë dhe të jetojë krejt mirë në Beograd. Ky është veç një tjetër tregues i qartë për natyrën paragjyquese dhe politike të po kësaj politike.

Natyrisht, ky vendim na ka lënduar dhe na ka zhgënjyer, por kurrë nuk do të na thyejë dhe kurrë nuk do të na dorëzojë. Unë jetoj dhe do të vdes me bindjen time të plotë në pafajësinë dhe çiltërsinë e babait tim, Hashimit, Kadriut dhe Rexhës. Krenaria mbetet. E vërteta mbetet. Ne do ta vazhdojmë luftën për liri dhe drejtësi”, shkruan ajo.

Pas dënimit ka folur shkurtimisht për mediat edhe edhe djali i Kadri Veselit.

“Të fortë jemi, të fortë do të qëndrojmë”, ka thënë ai. /CNA

- **Gjykata e Hagës shpall dënimin për Rexhep Selimin**
- **Gjyqi i Hagës/ Jepet dënimi për Jakup Krasniqin**
- **Gjyqi në Hagë/ Shpallet dënimi për Kadri Veselin**
- **Shpallet vendimi në Hagë për Hashim Thaçin/ Ja me sa vite burg dënohet**





Të sugjeruara

Vendimi i Hagës/ Konjufca: Gjykim i tmerrshëm për Kosovën dhe për luftën çlirimtare

Shpërthime, thirrje dhe marshim/ Si u prit dënimi i ish-krerëve të UÇK-së në Prishtinë

Gjykata e Hagës shpall dënimin për Rexhep Selimin

Gjyqi i Hagës/ Jepet dënimi për Jakup Krasniqin

Gjyqi në Hagë/ Shpallet dënimi për Kadri Veselin

Shpallet vendimi në Hagë për Hashim Thaçin/ Ja me sa vite burg dënohet

Seanca në Hagë/ Gjykatësi, me akuza të rënda: Thaçi mori pjesë personalisht në krime

Trupi gjykues në Hagë: 96 persona u vranë nga pjesëtarë të UÇK-së

Seanca në Hagë/ Trupi gjykues: U vërtetua arrestimi i paligjshëm i së paku 385 personave

Seanca për ish-krerët e UÇK-së/ Bie akuza për krime kundër njerëzimit

Sot vendimi final/ Nis seanca në Gjykatën Speciale të Hagës

Kongresmeni amerikan: Anshmëria politike të mos ketë vend në Hagë

Konjufca para hyrjes në Gjykatën Speciale: Sot shqiptarët presin vetëm vendimin e lirim

Çmime rekord karburantesh në Gjermani/ Merz premton ndërhyrje

Më pak se dy orë nga shpallja e vendimit/ Shqiptarët mblidhen para Gjykatës Speciale në Hagë

Para gjyqit në Hagë/ Policia holandeze merr masa, urdhër për konfiskim flamujsh

Sot fjalimi vendimtar i Von der Leyen mbi Evropën/ Ja ku pritet të jetë fokusi

Rrezohet helikopteri i medias amerikane, 3 viktima


Shefi i OpenAI: Njerëzit kanë të drejtë të frikësohen nga zhvillimi i IA

Të dhënat nga buxheti i shtetit/ Ja sa i kushtoi Kosovës mbrojtja e të akuzuarve në Hagë
[editorial](#)

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.